



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDARYSHE

## THIRRJE PËR OFERTË

### Hulumtim për gjendjen e hapësirave publike në qytetin e Lipjanit dhe Suharekës

Programi për të drejtat e njeriut, “HumanRigtivism”, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit, përmes këtyre tri komponentëve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi; monitorimi (watchdog) dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për raport/dokumentin “Hulumtim për gjendjen e hapësirave publike në qytetin e Lipjanit dhe Suharekës”.

Hulumtimi duhet të ofrojë informata mbi gjendjen dhe funksionet ekzistuese të të gjitha hapësirave publike të këtyre qyteteve, ku duhen analizuar kategoritë dhe funksionet e hapësirave publike, elementet dhe mobileria urbane e tyre, qasja për personat me aftësi të kufizuara dhe shfrytëzueshmëria e tyre.

Gjithashtu, hulumtimi duhet të përmbajë konkluzat e rekomandimeve se si këto hapësira do të mund të ishin më të shfrytëzueshme nga qytetarët dhe në fund të punohen infografika/kartela me analiza/krahasime për të gjitha hapësirat publike të hulumtuara me të dhënat nga hulumtimi në terren.

#### Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertët/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ~ Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, 10000 Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) ~ [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) ~ 029-222-771 & 038-224-967

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së);
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtë të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruar së paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më 03.11.2023 ,ora 15:00 me shënim: “Hulumtim për gjendjen e hapësirave publike të Lipjanit dhe Suharekës”. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më 01.11.2023.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët /grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.